

2494

113/3

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E QEVERISJES ELEKTRONIKE DHE INOVACIONIT
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMITNr. D-11101 prot.Tiranë, më 29 / 07 / 2024

Lënda: Kthim përgjigje

Z. DORIAN MATLIJA

Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrje 3, ap. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. D-11151, datë 04.07.2024 dhe ka kaluar për shqyrtim pranë strukturave përkatëse, të cilat kanë kthyer përgjigje si vijon:

"Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar me shkresën me nr. D-11151/1 prot., datë 19.07.2024 sqaron se të ardhurat nga tarifa e parkimit sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës nuk janë të ardhura me destinacion të posaçëm. Bashkia e Tiranës ka orientuar përdorimin e këtyre të ardhurave kryesisht për gjelbërimin e qytetit. Në këtë kuptim nuk mund të ketë një ndarje sipas nënkategorive të tarifave të parkimit për buxhetin e dedikuar për gjelbërimin.

Financimi i gjelbërimit të qytetit është bërë sipas nevojave specifike në një vit të caktuar, vlerësuar nga institucionet që administrojnë këtë shërbim për shtimin e sipërfaqeve të gjelbëruara, mirëmbajtje të hapësirave ekzistuese etj si dhe kërkesave për buxhetim. Investimet në gjelbërim janë shtrirë në të gjithë qytetin, nëpër shesh-pushimet ndërmjet pallateve nëpër shkolla, kopshte, parqe, rrugë kryesore dhe dytësore.

Buxhetimi i fondeve për gjelbërimin bëhet sipas programit buxhetor dhe institucioneve që janë pjesë e programit, referuar funksionit që kanë të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak. Buxhetimi i fondeve bëhet në total sipas tipologjisë dhe klasifikimit ekonomik në shpenzime personeli, operative dhe kapitale ku përveç shpenzimeve për gjelbërimin përfshihen dhe shpenzimet e administratës së institucioneve.

"Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit me shkresën me nr. 1670/1 prot., datë 18.07.2024 bën me dije se informacionin e kërkuar mund ta gjeni në faqen zyrtare të Open Data <https://opendata.tirana.al>".

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Blerta Goxha





Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>

Përgjigje nga Bashkia Tiranë shkresës me nr. prot. 1776/1, datë 26.07.2024

E Drejta Per Informim <edrejtaperinformim@tirana.al>
 To: "qendra.respublica@gmail.com" <qendra.respublica@gmail.com>
 Cc: "info@idp.al" <info@idp.al>

Thu, Aug 1, 2024 at 1:48 PM

Përshëndetje,

Referuar shkresës së ardhur nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me nr. 1776/1 prot., datë 26.07.2024 protokolluar pranë Bashkisë Tiranë me nr. prot. 28024, datë 29.07.2024 ju bëjmë me dije se nga strukturat përkatëse ka përgjigje si vijon mbi informacionin që disponojnë:

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar me shkresën me nr. D-11151/1 prot., datë 19.07.2024 sqaron se të ardhurat nga tarifa e parkimit sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës nuk janë të ardhura me destinacion të posaçëm. Bashkia e Tiranës ka orientuar përdorimin e këtyre të ardhurave kryesisht për gjelbërimin e qytetit. Në këtë kuptim nuk mund të ketë një ndarje sipas nënkategorive të tarifave të parkimit për buxhetin e dedikuar për gjelbërimin.

Financimi i gjelbërimit të qytetit është bërë sipas nevojave specifike në një vit të caktuar, vlerësuar nga institucionet që administrojnë këtë shërbim për shtimin e sipërfaqeve të gjelbëruara, mirëmbajtje të hapësirave ekzistuese etj si dhe kërkesave për buxhetim. Investimet në gjelbërim janë shtrirë në të gjithë qytetin, nëpër shesh-pushimet ndërmjet pallateve nëpër shkolla, kopshte, parqe, rrugë kryesore dhe dytësore.

Buxhetimi i fondeve për gjelbërimin bëhet sipas programit buxhetor dhe institucioneve që janë pjesë e programit, referuar funksionit që kanë të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak. Buxhetimi i fondeve bëhet në total sipas tipologjisë dhe klasifikimit ekonomik në shpenzime personeli, operative dhe kapitale ku përvec shpenzimeve për gjelbërimin përfshihen dhe shpenzimet e administratës së institucioneve.

"Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit me shkresën me nr. 1670/1 prot., datë 18.07.2024 bën me dije se informacionin e kërkuar mund ta gjeni në faqen zyrtare të Open Data <https://opendata.tirana.al>".

Ndërkohë Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit informon se shpenzime për blerje pemësh dhe donacione (nga qytetarë, biznese apo organizata etj) përgjatë viteve 2016-2024.

VITI	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
SHPENZIME PËR PEMË (blerje)	33.150.300	197.991.940	259.142.099	242.567.722	28.264.551	59.181.074	1.540.901	7.675.800	43.479.500
SHPENZIME PËR PEMË (donacion)	7.997.510	7.598.184	15.910.055	11.859.991	6.491.940	6.399.956	1.882.500	7.151.697	12.941.299
TOTALI	35.548.410	135.220.124	275.052.104	350.977.713	34.495.871	65.581.732	10.525.001	14.810.437	55.814.539
									715.078.938

Gjithashtu ju bëjmë me dije se i gjithë informacioni gjendet i publikuar në link-et si më poshtë.

<https://aprtirana.al/une-dhuroj/dhuro-nje-peme/dhuro-peme/>

<https://ckan.tirana.al/organization/apr> (duke klikuar më tej advanced)

<https://ckan.tirana.al/organization/drejtoria-e-pergjithshme-e-pastrimit-dhe-gjelberimit> (duke klikuar më tej advanced)

Ju falenderojmë për mirëkuptimin.

KOORDINATORE PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT



Bashkia Tiranë

Sheshi "SKËNDERBEJ",
Nd. 2, Kodi postar 1001,
Tiranë, Shqipëri

Web: www.tirana.al

Informacioni i transmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privileguara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, transmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjektet e tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të transmetuar në kompjuterin tuaj. Na nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruset, përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.